Strategjia dhe plani i avokimit dhe komunikimit për HANDIKOS dhe Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi - RBB

Periudha kohore: 2020 -2022

Ky publikim është botuar me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e HANDIKOS-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e UNICEF-it.

Përmbajtja

- Lista e Shkurtesave..... 4
- Hyrje..... 5
- Historiku..... 5
- Qëllimi..... 7
- Metodologjia..... 7
- Objektivat Strategjike – në fushën e avokimit..... 8
- Objektivat Strategjike – në fushën e komunikimit..... 12
- Plani i Veprimit për Strategjinë..... 18
- Lista e QRBB-ve pjesëmarrëse në punëtoritë për draftimin e Strategjisë 28

Lista e shkurtesave:

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

DSHMS – Drejtoria Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

DSHP – Drejtoria për Shërbime Publike

DU – Drejtoria e Urbanizmit

FAK – Fëmijë me Aftësi të Kufizuara

KNF – Klasifikimi Ndërkombëtare i Funksionalitetit

MF – Ministria e Financave

MPMS – Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale

MSH – Ministria e Shëndetësisë

OJQ – Organizatë Jo Qeveritare

PAK – Persona me Aftësi të Kufizuara

QRBB – Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi

RBB – Rehabilitimi i Bazuar në Bashkësi

PIA – Plani Individual i Arritshmërisë

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Hyrje

Të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti të fëmijëve me aftësi të kufizuara ende nuk janë të realizuara në nivel vendi dhe rrjedhimisht edhe në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ndaj, HANDIKOS në kuadër të përgjegjësive dhe me qëllim të avokimit të përbashkët me QRBB dhe bashkërendimit të aktiviteteve avokuese në nivelin qendror dhe atë lokal, ka inicuar hartimin e strategjisë së avokimit si dhe planin e avokimit. HANDIKOS së bashku me QRBB synojnë që përmes veprimeve avokuese të përbashkëta të zvogëloj sfidat dhe barrierat të cilat krijojnë vështirësi në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 15 % e popullatës botërore janë persona me aftësitë kufizuara[1]. Në Kosovë akoma nuk kemi shifra të sakta rreth këtij numri të komunikuar zyrtarisht nga institucionet publike dhe ky numër bazohet në përfituesit e skemave sociale dhe pensionet e aftësisë së kufizuar. Përkundër mungesës së të dhënave të sakta, megjithatë dihet se fëmijët me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të margjinalizuar dhe të hasin në vështirësi të cilat shpesh mund të cilësohen edhe si diskriminuese sa i përket gjithpërfshirjes së tyre por edhe qasjes së tyre në shërbime.

Gjithpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin arsimor, por edhe sigurimi i mbështetjes se fëmijëve me aftësi të kufizuara vazhdon të jetë sfidë për të gjithë sistemin arsimor. Në anën tjetër, shërbimet sociale në komunitet për personat me aftësi të kufizuara në nivel komunal janë të kufizuara, ndërsa shërbimet sociale të ofruara nga OJQ-të kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, ndërkohë që mbështetja shtetërore nuk është e strukturuar, nuk është e qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë mbetet shumë e kufizuar dhe pa një qasje afatgjatë. Madje sipas agjensionit të statistikave në Kosovë vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale. *(Të dhënat: Agjencinë e Statistikave të Kosovës 2018)*. Me qëllim të përfshirjes në agjendën e institucioneve në nivel qendrore dhe atë lokal është e nevojshme që organizatat të cilat përfaqësojnë interesat e fëmijëve e aftësi të kufizuara si dhe komuniteti të bashkërendojnë dhe të ndërmarrin veprime në nivelin qendror dhe atë lokal që të përmirësojnë situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Historiku

HANDIKOS është themeluar në vitin 1983 me qëllimin kryesor për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HANDIKOS gëzon shtrirjen më të gjerë në Kosovë me prani aktive në 98% të territorit të vendit dhe vazhdon të mbrojë në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e PAK, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës.

HANDIKOS vazhdon të mbetët një ndër ofruesit kryesorë të shërbimeve të rehabilitimit primar për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, në 14 Qendra dhe 13 zyre lokale. Shërbimet kyçe të

[1] https://www.who.int/disabilities/world_report/2011/report/en/

ofruara nga HANDIKOS në kuadër të Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi kanë për qëllim të ruajnë dhe avancojnë shëndetin fizik dhe atë mendor të personave me aftësi të kufizuara, përmes rehabilitimit primar fizikal dhe atij psiko-social, ofrimit të pajisjeve ndihmëse, këshillimit grupor dhe individual për prindër/kujdestar, sistemit të referimit, vizitave / mbështetjes në shtëpi dhe programeve fuqizuese për jetesë të pavarur dhe ngritje të kapaciteteve.

HANDIKOS nga viti 2018 është duke implementuar strategjinë e saj zhvillimore (2018-2022) e cila ka për vizion *një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara* dhe mision *të arrij ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre.* Në kuadër të strategjisë pesë vjeçare janë përcaktuar *pjesëmarrja; punësimi; edukimi & trajnimi; mirëqenia sociale; shëndeti; & zhvillimi organizativ* si objektiva strategjike[2].

Në Kosovë, Qendrat e Rehabilimit të Bazuar në Bashkësi kanë lansuar shërbimet që nga viti 1996, dhe momentalisht funksionojnë në 13 qendra të HANDIKOS në të gjithë vendin. Aktualisht Qendrat e RBB-së ofrojnë shërbime me bazë në komunitet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, duke synuar qasje gjithëpërfshirëse në kopshte, shkolla, treg të punës dhe komunitet.

Qëllim primar i Programit të RBB-së mbetët avancimi i situatës së fëmijëve ne aftësi të kufizuara në vend, përmes ofrimit të shërbimeve rehabilituese, shërbime të cilat janë të dizajnuara për të mbështetur zhvillimin holisitik të personit. Përderisa në mandat të saj ka ofrimin e shërbimeve rehabilituese në komunitet (për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara); shërbime për prindër dhe kujdestar të PAK; avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara duke përfshirë këtu koordinimin me institucionet e linjës në identifikimin dhe intervenimin e hershëm, integrimin në proceset e rregullta edukative, përfshirjen e PAK në sferën sociale dhe legjislacionin relevant për avancimin e situatës së tyre në shoqëri.

Qendrat e RBB-së orientohen nga parimi i respektimit të të drejtave njerëzore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe me një sjellje të natyrës pjesëmarrëse ku mendimi i përfituesve të shërbimit kërkohet dhe merret në konsideratë, pavarësisht faktorëve dhe prapavijave sociale që i rrethojnë ata.

Ofrimi i shërbimeve mbështetet në parimin për të kontribuar në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm të integrimit dhe zhvillimit, i cili synon të garantojë për të gjithë mundësinë e përmbushjes së nevojave bazike si dhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.

Shërbimet që ofrohen nga këto qendra përfshijnë një larmi programesh të hartuara për të përmbushur nevojat dhe interesat e përfituesve të shërbimit si dhe referimeve apo mbështetje për të përdorur shërbime të ofruara nga struktura të tjera të specializuara.

[2] http://handi-kos.org/repository/docs/Strategjia_2018-2022___ALB_ENG_840110.pdf

Qëllimi

HANDIKOS në mandatin e saj si dhe nga memorandumi i bashkëpunimit me të gjitha Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi, ka të punoj ngushtë me rrjetin e QRBB-ve në Kosovë drejt avancimit të situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend. Si rrjedhojë këtë, HANDIKOS e reflekton në programet e saj, programe të cilat mbështeten nga donatorë të ndryshëm të huaj dhe vendor. Në fillim të vitit 2017 e deri në përfundim të viti 2019, me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë me fonde të BE-IPA II është punuar ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e QRBB-ve në identifikimin e mangësive në shërbimet që ofrohen për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe hapësirat për përmirësim në nivel organizativ. Si rrjedhojë është hartuar edhe raporti përshkrues për gjendjen aktuale të QRBB-ve dhe rekomandimeve se si do duhet të përmirësohet kualiteti I shërbimeve të ofruara nga RBB-të dhe funksionimi organizativ3.

Bazuar në këtë, HANDIKOS me mbështetje të UNICEF, zyra në Kosovë, dhe në partneritet të ngushtë me të gjitha QRBB-të, rekomandimet e dala në raportin vlerësues kanë adresuar në një dokument që përfshin fushën avokuese të QRBB-ve për adresimin e çështjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend si dhe komunikimin e tyre.

Metodologjia

Procesi i zhvillimit të Strategjisë dhe Planit të Avokimit dhe Komunikimit është iniciuar nga HANDIKOS në kuadër të projektit 'Avancimi i situatës së fëmijëve e aftësi të kufizuara në Kosovë' mbështetur nga zyra e UNICEF në Kosovë me periudhë implementuese Shtator 2019-Dhjetor 2020.

Të dhënat lidhur me kapacitet avokuese janë mbledhur paraprakisht përmes pyetësorit të vlerësimit të kapaciteteve avokuese të HANDIKOS dhe QRBB si dhe janë ndarë pyetësorët për të vlerësuar nivelin e avokimit të tyre. Gjatë punëtorive përveç ndarjes së rezultateve pyetësorëve me pjesëmarrësit janë identifikuar fushat kryesore në të cilat do të fokusohet avokimi në nivel vendor por edhe atë komunal. Veç tjerash, më 13-15 dhjetor 2019 u mbajt punëtoria tre-ditore me përfaqësuesit e HANDIKOS dhe QRBB për hartimin e strategjisë së avokimit. Gjatë punëtorisë janë ndarë edhe praktikat dhe përvojat më të mira të QRBB në fushën e avokimit me qëllim të përsëritjes së praktikave të mira dhe arritjes së rezultateve. Fillimisht përmes formularëve për identifikim të çështjeve janë identifikuar fushat në të cilat do të fokusohen aktivitetet avokuese në nivelin qendror dhe atë lokal si dhe janë përcaktuar objektivat strategjike. Me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira përmes analizës së akterëve janë identifikuar partnerët dhe përkrahësit në nivel qendrorë dhe lokalë të objektivave dhe veprimeve avokuese si dhe janë identifikuar edhe akterët drejt të cilëve do të synohen veprimet avokuese.

Si rezultat i punëtorisë tre-ditore pjesëmarrësit kanë dalur me draftin e parë të strategjisë për avokim si dhe planin e avokimit. Përderisa aktivitetet dhe objektivat strategjike janë prioritizuar nga vetë pjesëmarrësit e punëtorisë (përfaqësuesit e QRBB-ve).

[3] http://ëëë.handi-kos.org/repository/docs/Raporti_i_RBB_857904.PDF

Objektivat strategjike – në fushën e avokimit

Strategjia e Avokimit 2020 -2022 do të përcaktoj veprimet dhe aktivitetet avokuese drejt institucioneve qendrore dhe lokale si dhe komunitetit. Objektivat strategjike avokuese kanë për qëllim të transmetojnë synimet e HANDIKOS dhe QRBB për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjes së tyre të plotë në shoqëri, duke fokusuar aktivitetet të cilat do të ndërmerren drejt realizimit në nivelin qendror dhe atë lokal

Objektivat strategjike janë formuluar duke marrë parasysh sfidat dhe problemet ekzistuese me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre por edhe HANDIKOS dhe QRBB si ofrues të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mungesa e gjithpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, mungesa e përkrahjes së tyre për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, mungesa e qasjes fizike në institucionet arsimore dhe qasjes në shërbime sociale dhe familjare, mungesa e mekanizmave për zbatimin e legjislacionit, mungesa e identifikimit dhe intervenimit të hershëm vazhdimi i diskriminimit të tyre janë disa nga sfidat dhe pengesave me të cilat ende vazhdojnë të përballen fëmijët me aftësi të kufizuara. Shërbimet sociale dhe familjare sipas legjislacionit në fuqi përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për personat në nevojë për mbrojtje sociale, përfshirë fëmijët apo personat me aftësi të kufizuara. Në Kosovë përveç qendrave për punë sociale të cilat janë të mandatuara për të ofruar shërbime sociale janë edhe rreth 30 OJQ të licencuara nga MPMS për të ofruar shërbime sociale për personat dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje sociale. Në anën tjetër përkundër decentralizimit të shërbimeve sociale të bëra nga viti 2019, sipas Raportit të Monitorimit4 për procesin e decentralizimit, shërbimet sociale janë në gjendje të rëndë dhe përballën me sfida të shumta përfshirë mungesën e financimit të qëndrueshme të shërbimeve socaiale, cilësinë e ulët të shërbimeve etj. Sipas po të njëjtit raport ende nuk ka një skemë të qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe mbështetja ndaj OJQ-ve ofrohet në baza *ad hok* dhe përmes subvencionimit. Në anën tjetër sikurse është theksuar edhe në Analizën e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara financimi i HANDIKOS është përzierje e fondeve të donatorëve dhe tenderit të ofrimit të shërbimeve nga komunat5.

Po ashtu Analiza e Situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara përveç të gjeturave dhe rekomandimeve të shumta thekson dhe rekomandon përshpejtimin e një sistemi të identifikimit të hershëm dhe intervenimit të hershëm i cili respekton përkufizimin e aftësisë së kufizuar sipas modelit social si dhe krijimin e kryhet nga ekipet e profesionistëve multidisiplinar dhe shpie në ofrimin e shërbimeve në mjedise gjithëpërfshirëse si dhe nevojën për qasje multidisiplinare, duke filluar sa më herët që të jetë e mundur në bashkëpunim të ngushtë me metodologjitë e identifikimit të hershëm/intervenimit të hershëm.

Duke marrë parasysh fushëveprimin dhe qëllimin e HANDIKOS dhe QRBB për të avancuar situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të shërbimeve por edhe avokimit për realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara adresimi i mirëfilltë i këtyre çështjeve jo vetëm që do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës jetësore, përmbushjen e nevojave dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara por do të ndikoj edhe në

[4] http://ëëë.komfkosova.org/17519-2/

[5] https://ëëë.unicef.org/kosovoprogramme/reports/situation-analysis-children-disabilities-kosovo

zhvillimin, përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e HANDIKOS dhe QRBB e që është rekomanduar edhe në vlerësimin e fundit të funksionimit të të QRBB-vë në Kosovë[6].

Objektivat strategjike të avokimit përfshijnë aspektet kryesore të fëmijëve me aftësi të kufizuara me fokus të veçantë në fushat në vijim: arsim, qasje, qëndrueshmërinë e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në RBB dhe plotësimin e kornizë ligjore.

Detajet e objektivave strategjike, aktivitetet e planifikuara të cilat do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike të avokimit dhe rezultatet e pritshme janë si në vijim:

Objektiva strategjike 1 në fushën e qasjes: Deri në fund të vitit 2022 është rritur numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë qasje në institucionet arsimore dhe shërbime

Kjo objektivë strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt me veprimet avokuese lidhur me qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet shkollore në nivel të vendit si dhe qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbime Identifikimi i sfidave dhe gjendjes aktuale lidhur me qasjen e fëmijëve në institucionet arsimore dhe shërbime do të shërbejnë si aktivitete të cilat do të lehtësojnë aktivitetet avokuese lidhur me qasjen

Rezultatet e pritshme:

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë qasje në arsim dhe shërbime të cilat do të kontribuojnë në arritjen e potencialit të plotë

Aktivitetet e planifikuara

Në vijim janë paraqitur disa nga aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- Punëtori për prezantimin e gjendjes aktuale/raportit mbi qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla së shkollave në Kosovë
- Promovimi i shkollave të qasshme në Kosovë – ndarja e praktikave më të mira
- Hartimi i plani komunal të veprimit për adresimin e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla
- Hulumtim – qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbimet sociale (# i komunave)
- Video / materiale avokuese për qasjen në shërbime të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Objektiva strategjike 2 në fushën e qëndrueshmërisë së shërbimeve të QRBB : Deri në vitin 2022, QRBB kanë ngritur qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të integruara për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, përmes përcaktimit të kodit buxhetor për shërbime sociale dhe të integruara në nivel komunal

Kjo objektivë strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt në ngritjen e qëndrueshmërisë së shërbimeve të integruara të QRBB për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara përmes veprimeve dhe fushatave avokuese në komunat ku QRBB ofrojnë shërbime.

[6] http://ëëë.handi-kos.org/repository/docs/Raporti_i_RBB_857904.PDF

Rezultatet e pritshme:

QRBB kanë ngritur qëndrueshmërinë financiare dhe kanë ngritur cilësinë e shërbimeve për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara

Aktivitetet e planifikuara

Në vijim janë paraqitur disa nga aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- Punëtori informuese me asambleistët komunal mbi të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara
- Punëtori informuese me asambleistët komunal mbi shërbimet, përfituesit e shërbimeve të QRBB dhe rëndësinë e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve
- Punëtori për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit për PAK si dhe përcaktimin e kodit buxhetor
- Takime avokuese me Komitetin për Politikë dhe Financa për miratimin e strategjisë dhe planit te veprimit për PAK dhe për ndarjen e kodit buxhetor për shërbime për PAK
- Takime avokuese me asambleistët për miratimin e strategjisë dhe planit te veprimit për PAK
- Takime avokuese me drejtoritë përkatëse për planifikimin buxhetor për 2021

Objektiva strategjike 3 në fushën e legjislacionit: Përfshirja e aftësisë së kufizuar në kornizën ligjore dhe zbatimi i tyre

Kjo objektivë strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt veprimet avokuese lidhur me përfshirjen e aftësisë së kufizuar në plotësim ndryshimet e kornizën ligjore por edhe akteve tjera sekondare.

Rezultatet e pritshme:

Kuvendi i Kosovës siguron që ligjet të cilat dërgohen në kuvend për aprovim kanë të përfshira edhe aspektet ligjore

Fillon zbatimi i ligjeve të cilat ndërlidhen me aftësinë e kufizuar

Aktivitetet e planifikuara

Në vijim janë paraqitur disa aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- Takime me politikë bërës, me komisionet e grupeve parlamentare mbi përfshirjen e aftësisë së kufizuar në kornizën ligjore
- Takimet me Ministritë Relevante mbi zbatimin e kornizës ligjore (MPMS, MSH, MF)
- Takime me deputet e Komunave në Parlamentin e Kosovës
- Lobimi për përfshirjen e aftësisë së kufizuar gjatë plotësim ndryshimeve të kornizës ligjore

Objektiva strategjike 4 në fushën e arsimit: Rritja e pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim përmes ngritjes dhe fuqizimit të sistemit mbështetëse në institucionet arsimore

Iniciativat dhe aktivitetet avokuese për arsim gjithëpërfshirës si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimor janë paraparë me synim për të për të ngritur dhe fuqizuar sistemin mbështetës në institucionet arsimor me qëllim të përfshirjës së të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor si dhe përkrahjen e zhvillimit të potencialit të tyre të plotë me theks të veçantë në PIA dhe KNF

Rezultatet e pritshme

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në procesin arsimor është ngritur

Mësimdhënësit dhe stafi mbështetës kanë ngritur kapacitetet e tyre për t'iu përgjigjur nevojave për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë informata dhe përkrahin fëmijët e tyre në procesin arsimor

Aktivitetet e planifikuara

Në vijim janë paraqitur disa nga aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- Hulumtim i numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë të përfshirë në shkollë të rregullt dhe nevojave për mbështetje.
- Konferenca lokale mbi rezultatet e hulumtimit mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në shkolla dhe nevojave për mbështetje
- Takime për me MASHT dhe DKA për funksionalizimin dhe fuqizimin e ekipeve vlerësuese komunale
- Hulumtimi mbi përdorimin e PIA dhe instrumenteve vlerësuese dhe njohurive për KNF nga mësimdhënësit dhe nevojat e ngritjes së kapaciteteve të stafit mbështetës ekzistues dhe të rinj.
- Takime me DKA dhe MASHT për ngritjen së kapaciteteve të stafit mbështetës ekzistues dhe të rinj për t'iu përgjigjur nevojave për mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Aktivitete avokuese brenda shkollave (takime, punëtori, etj.) për mësimdhënësit e rregullt mbi përdorimin e instrumenteve vlerësuese dhe KNF
- Punëtori konsultative dhe informuese me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara mbi rëndësinë e PIA-s dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të rregullta
- Shkëmbimi i informatave dhe praktikave pozitive në mes të shkollave/qyteteve te ndryshme

Grupet e synuara:

Përgjatë përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve të cilat do të kontribuojnë në realizimin e objektivave janë përcaktuar edhe grupet e synuara drejt të cilave do të drejtohen aktivitetet

avokuese dhe të cilat kanë kompetencë të drejtpërdrejtë apo mund të ndikojnë që të ndryshojnë dhe të përmirësojnë situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
Grupet e synuara janë klasifikuar në nivelin qendror dhe atë komunal/lokal varësisht nga aktivitetet. Grupet e synuara në nivelin qendror janë: Kuvendi i Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Zyra e Avokatit të Popullit. Njëherit aktivitet të cilat kanë për synim nivelin qendror do të zbatohen nga HANDIKOS në qendër.
Grupet e synuara në nivelin lokal janë: Kryetarët e Komunave, Drejtoritë e Arsimit, Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoritë e Urbanizimit, Drejtoritë e Financave, Asambleja Komunale, asambleistët komunal, Shkollat, Drejtorët e Shkollave dhe mësimdhënësit. Aktivitetet të cilat kanë për synim nivelin komunal do të zbatohen nga RBB por do të mbështeten nga HANDIKOS në qendër si rezultat i një numri të hulumtimeve lidhur me numrin, përkrahjen dhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Buxheti

Përllogaritjet e buxhetit për zbatimin e strategjisë së avokimit janë bërë me qëllim të përcaktimit të kornizës financiare dhe fondeve të nevojshme për zbatimin e strategjisë së avokimit në periudhën 3 vjeçare si dhe me qëllim të identifikimit të nevojave financiare të cilat mund të mbulohen nga donatorët potencial.

Partnerët dhe mbështetësit

Me qëllim të rritjes së ndikimit të aktiviteteve avokuese, kjo strategji parasheh partneritetin me organizata të cilat kanë mision të ngjashëm me HANDIKOS dhe QRBB si dhe angazhimin e personaliteteve të cilat do të mund të jenë pjesë e aktiviteteve duke avokuar së bashku me HANDIKOS dhe QRBB për realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Partneritet do të krijohen në pajtim me aktivitetet, pra në nivelin qendror dhe atë lokal. Disa nga partnerët e identifikuar janë OJQ të cilat përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara (përfshirë nivelin qendrorë dhe atë lokal, varësisht nga aktivitetet), shkollat dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Për të adresuar më mirë çështjet avokuese të ngritura nga përfaqësuesit e QRBB-ve në kuadër të të njëjtës mbështetje janë hartuar edhe objektivat strategjike të komunikimit të cilat janë në linjë me ato të fushës së avokimit. Për më tepër, janë hartuar kanalet e komunikimit të cilat QRBB-të do duhej të ndjekin në arrtishmërinë e objektivave avokuese për të avancuar situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend.

Objektivat strategjike – në fushën e komunikimit

Fusha e komunikimit është përpiluar duke marr në konsideratë sfidat dhe problemet ekzistuese me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre po edhe vet HANDIKOS dhe QRBB-të, si ofrues të shërbimeve rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mungesa e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, mungesa e përkrahjes për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, mungesa e qasjes në shërbime rehabilituese duke përfshirë edhe mungesën e mekanizmave për zbatimin e kornizës ligjore në vend janë disa nga sfidat dhe

pengesave me të cilat ende vazhdojnë të përballen fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo është elaboruar edhe gjatë punëtorisë së Avokimit dhe Komunikimit, e cila është zhvilluar me përfaqësuesit e HANDIKOS dhe QRBB-ve gjatë muajit Dhjetor 2019. Përcaktimi i objektivave është bërë në përputhje po ashtu me objektivat e strategjisë së avokimit, e të cilat krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me qasjen e fëmijëve në arsim dhe shërbime, si dhe përmbushjen e kornizës ligjore për personat me aftësi të kufizuara.

Si rrjedhojë, nga diskutimi i grupit janë përcaktuar tri (3) objektiva të përgjithshme në fushën e komunikimit e të cilat kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike brenda kësaj strategjie:

- Arritja e sa më shumë personave me aftësi të kufizuara për QRBB-të;
- Komunikimi i efektshëm me partnerët në Kosovë;
    - Komunikimi i vazhdueshëm i rezultateve të programit
- Identifikimi i mënyrave dhe kanaleve të komunikimit për të arritur audiencën e tretë (donatorët potencial dhe audiencën e përgjithshme).

Si rrjedhojë në kuadër të fushave / objektivave të përgjithshme të synuara në kuadër të Strategjisë, janë identifikuar këto objektiva specifike në të cilat përfaqësuesit e QRBB-ve synojnë të fokusohen përgjatë tre-vjetorit të ardhshëm.

- **Outreach – Komunikimi në terren me personat me aftësi të kufizuara**

Të arrihen së paku 1000 persona me aftësi të kufizuara, të cilët potencialisht mund të përfshihen në aktivitetet / shërbimet ë HANDIKOS/QRBB-së (të paktën 40% e tyre të jenë vajza/gra).

- **Komunikimi me partnerë**
    - Komunikim mujor me partnerët kyç – të cilët janë në një formë apo tjetër të lidhur me programin e RBB-së;
    - Takime të rregullta kuartale me partnerët kyç të cilët në një formë apo tjetër janë të lidhur me programin e RBB-së
    - Informimi i rregullt i partnerëve për aktivitetet, të arriturat dhe eventet kryesore të HANDIKOS dhe QRBB-ve
- **Komunikimi me audiencën e përgjithshme**

Në bashkëpunim me të gjitha QRBB-të (përfshirë edhe organizatat tjera partnere, të cilat merren me çështjen e aftësisë së kufizuar apo kanë për fokus adresimin e të drejtave të fëmijëve/njeriut) duhet të organizohen ngjarje publike, së paku dy herë në vit, të cilat do të flisnin për programin në përgjithësi, si dhe për intervenimet specifike të HANDIKOS dhe QRBB-ve.

Qëndrueshmëria e QRBB-ve është një nga fushat e cila është vlerësuar të jetë kruciale për funksionimin e rregullt të tyre dhe adresimin më të mirë të nevojave të fëmijëve me aftësi të

kufizuara (përmes implementimit të modelit të ri të propozuar të RBB-së[7]), e theksuar përgjatë punëtorisë së Dhjetorit (2019) e organizuar për të njëjtin qëllim.

Si rrjedhojë e saj, fushat në të cilat QRBB-të, mesazhet e tyre do komunikojnë (e që janë në linjë të plotë me fushat e paracaktuara në fushën e avokimit) janë:

- Qasja
  - Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë qasje fizike në institucionet arsimore dhe shërbime
- Qëndrueshmëria e shërbimeve të vazhdueshme për fëmijë me aftësi të kufizuara;
  - QRBB-të kanë ngritur qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbime të integruara për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara përmes përcaktimit të kodit buxhetor për shërbime të integruara në komunitet
- Korniza ligjore (në linjë me çështjet relevante të fëmijëve me aftësi të kufizuara);
  - Përfshirja e çështjeve relevante me aftësinë e kufizuar në kornizën ligjore dhe zbatimi i tyre;
- Edukimi gjithëpërfshirës;
  - Rritja e pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes ngritjes dhe fuqizimit të sistemit mbështetës në institucione arsimore

Në arritjen e objektivave të synuara është e rëndësishme të përcaktohen grupet e synuara të cilat iu adresohen intervenimet specifike në kuadër të objektivave strategjike. Mesazhet komunikuese në kuadër të objektivave strategjike në fushën e komunikimit janë si në vijim:

- Partnerët – zyrtarët publik; palët e treta; prindërit; mësimdhënësit; influencuesit në komunitet; politik bërësit; institucionet e linjës; organizatat partnere/mbështetëse; komuniteti i biznesit;
- Të rinjtë – nxënësit; studentët
- Donatorët e tjerë – palët të cilët nuk kanë qenë të përfshirë më herët;

Përderisa, mesazhet (në fushat e bashkë caktuara) do duhej të komunikohen përmes shfrytëzimit të kanaleve të komunikimit për të adresuar më mirë çështjet e ngritura.

